



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 4.3.2025

Nr: 237

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “NISMA SHQIPËRIA BËHET-ADRIATIK LAPAJ”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot, më datë 4.3.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me datë 3.3.2025, me:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar Z. Adriatik Lapaj
OBJEKTI: Regjistrimi i koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
BAZA LIGJORE: Neni 65, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar Z. Adriatik Lapaj, brenda afatit ligjor të përcaktuar ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me datë 3.3.2025, për regjistrimin e koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, është depozituar marrëveshja e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në koalicion, të cilat do të jenë: 1. Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, 2. Partia “Nisma Thurje”, 3. Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”.

Data: 4.3.2025 Nr: 237
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, (NISMA-SHB), për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të 3 (tre) partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “ NISMA-SHB”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Partia udhëheqëse e koalicionit është Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”;
6. Autorizimin e Zj. Dorina Prethi, përfaqësuese e Partisë “Lëvizja Shqipëria Bëhet” të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listat shumëmemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit;
7. Autorizimin e Zj. Dorina Prethi, e cila do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
8. Autorizimin e Zj. Dorina Prethi, e cila do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ, si dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor:

- a) Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
- b) Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ketë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e koalicionit.
- c) Kushti i tretë është që numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion duhet të jetë dy ose më shumë se dy.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se kërkesa për t’u regjistruar si koalicion, është e bazuar për partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar Z. Adriatik Lapaj, i përfaqësuar nga Zj. Dorina Prethi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 157 datë 24.2.2025.
2. Partia “Nisma Thurje”, me kryetar Z. Endrit Shabani, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 144 datë 24.2.2025.
3. Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me kryetar Z. Marjus Malaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 182 datë 25.2.2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 3 (tre) partitë e sipërcituara është në përputhje me nenet 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Regjistrimin e Koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj” përfaqësuar nga Z. Adriatik Lapaj me shkronja nistore “NISMA-SHB”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025, e përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:
 1. Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” (SHB);
 2. Partia “Nisma Thurje” (NISMA);
 3. Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë” (LDPSH).
2. Partia udhëheqëse e Koalicionit është Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” (SHB), përfaqësuar nga Z. Adriatik Lapaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI